



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

Nr. Prot.

Vlorë, më 27.04.2017

Vendim
Nr. 60, datë 27.04.2017

PËR
DHËNIE MENDIMI PËR KATEGORITË E PAGAVE TË PERSONELIT
AKADEMIK NË UNIVERSITETIN "ISMAIL QEMALI" VLORË

Në mbështetje të shkronjës ç, pika 4 në nenin 3, nenin 38 të Ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë", pikës 17 në VKM-në nr. 329, datë 12.04.2017 "Për statusin dhe trajtimin e veçantë të personelit akademik", Senati Akademik në mbledhjen e datës 27.04.2017

VENDOSI:

1. Të bëjë konstatimet e mëposhtme:
 - a. Pika 17 e VKM-së nr. 329, datë 12.04.2017 "Për statusin dhe trajtimin e veçantë të personelit akademik" është në kundërshtim me Ligjin Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë".
 - b. Kategoritë e pagave për pozicion janë në mospërputhje me kategoritë e personelit akademik të përcaktuara në Ligjin Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë".
 - c. Kategoritë "zv/dekan", "përgjegjës i njësisë bazë" dhe "titullar i grupit mësimor-kërkimor" për të njëjtën kategori nuk janë të diferencuara në pagë në bazë hierarkie dhe funksionesh përkatëse.
2. Vendimi regjistrohet dhe arkivohet.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Roland ZISI

Ky dokument përpilohet në 3 (tri) kopje.